

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe të Minierave, Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, Grupi Mësimor Kërkimor i Gjeomatikës, kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik te kategorisë Lektor me kohë të plotë si më poshtë;

Kandidati duhet të plotësojë këto kriterë:

1. Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, UPT, Master në Inxhinieri e Burimeve Minerare – profili Gjeomatikë ose Inxhinier Markshajder (sistemi 5- pesë vjeçar), ose në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili Gjeodezi, UPT, ose në universitete të huaja analoge, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor +Master Shkencor) në fushën e Markshajderisë dhe të Topografisë;
2. Nota mesatare e studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), të studimeve (Bachelor dhe Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (e barabartë ose më e lartë se 8);
3. Të ketë, së paku, gradën shkencore “Doktor”. Titulli akademik përbën përparësi.
4. Preferohet të ketë përvojë pune në fushën e Gjeomatikës/ Markshajderisë dhe të Topografisë;
5. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.
6. Përvoja në mësimdhënie përbën përparësi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS
5.);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **14.10.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.